



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Deisvety	07-08	3	viti god Year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPJESHCK	5563/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.834/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani Kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrta i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.834/2023 të datës 09.06.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Komunes së Suharekës, në çështjen juridike "Kompensim Material", në mbështetje të Nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenit 16 paragrafi 3 dhe Nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.834/2023 e datës 09.06.2023 e parashtruar nga ankuesi

Arsyetim

Ankuesi . punësuar sipas Akt Emërimit me numër 01-Nr.01-020/01-60354 të datës 30.11.2017 në pozitën e punës "Zyrta Ligjor 1" - LI/070 në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër në Komunën e Suharekës, më datë 06.06.2023 përmes Postës ka parashtruar ankesë e cila në Këshill është protokolluar me numër 4654/2023 me datë 09.06.2023, me pretendimin ankimor për shkak të mos vendosjes për shtesa të rrezikshmërisë në vendin e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores

Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Suharekës, ndërsa Këshilli më datë 26.06.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga e njëjta me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 24.07.2023 ka nxjerr Vendim VK/2023 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokoli 4654/2023 të datës 09.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për shtesa të rrezikshmërisë në vendin e punës e ankuesit me numër 01-181-30386 i datës 11.05.2023; Njoftim nga Zyra e Personelit e Komunës së Suharekës me numër 01-Nr-104-35282 i datës 02.06.2023; Aktgjykim i Gjykatës Themelore Prizren dega Suharekë me numër P.nr.24/18 i datës 02.04.2019; Thirrje për shqyrtim kryesor i datës 04.03.2019; Foto gjatë ekzekutimeve të uzurpimeve në teren; Konkurs për pozitën "Zyrtar Ligjor 1" në Komunën e Suharekës me numër 01-Nr-16-8550 i datës 13.08.2015; Akt Emërim i A.B. me numër 01-Nr.01-020/01-60354 i datës 30.11.2017; Letërnjoftim i A.B.; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" i A.B. me numër Nr.1003 i datës 11.12.2015; Pliko me numër R2939775 i datës 06.06.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 23.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 26.06.2023; E-mail nga C.Z. për A.H. i datës 23.06.2023; E-mail nga A.H. për C.Z. i datës 26.06.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 26.06.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 12.12.2016; Vendim i KPMSHCK me numër VK/2023 me numër protokoli 5329/2023 i datës 24.07.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi **është e pabazuar, SEPSE:**

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar se ankuesi mbanë pozitën "Zyrtar Ligjor 1" - LI/070 në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër në Komunën e Suharekës sipas Akt Emërimit me numër 01-Nr.01-020/01-60354 të datës 30.11.2017. Ankuesi me datë 11.05.2023 me numër 01-181-30386 ka bërë kërkesë për shtesa të rrezikshmërisë në vendin e punës tek zyra e personelit në Komunën e Suharekës duke u bazuar në nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik. Ndërsa zyra e personelit e Komunës së Suharekës përmes njoftimit me numër 01-Nr-104-35282 të datës 02.06.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin se nuk i takon shtesa e rrezikshmërisë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i pakënaqur me njoftimin me numër 01-Nr-104-35282 të datës 02.06.2023 të Komunës së Suharekës, pretendon që ti njihet e drejta për shtesë të rrezikshmërisë në vendin e punës duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik bazuar në nenin 26 si dhe Rregulloren (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave fillimisht ka analizuar Përshkrimin e Detyrave të Punës për pozitën "Zyrtar Ligjor 1" - LI/070 në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër në Komunën e Suharekës të ankuesit i cili përmban këtë përshkrim: 12. *Detyrat Kryesore: (përshkrimi i shkurtër i detyrave kryesore, të renditura për nga rëndësia dhe një përshkrim i përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë). Detyra 1: Harton akte normative si dhe akte tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Detyra 2: Siguron përputhshmërinë e projektligjeve dhe akteve tjera nënligjore me legjislacionin në fuqi në Kosovë. Detyra 3: Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik. Detyra 4: Bënë hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim. Detyra 5: Sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinione ligjore si dhe bënë hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve tjera. Detyra 6: Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit. Detyra 7: Zhvillon procedurën administrative për uzurpim arbitrarë të tokës në pronën shtetërore. Detyra 8: Ndhmon Drejtorin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime, përmisime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës. Detyra 9: Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund ti kërkojnë kohë pas kohe nga eprori.*

Në kuptim të vendosjes meritorie lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i 'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për pagat në sektorin publik konkretisht nenit 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 si dhe nenit 26 paragrafit 1 me të cilin është përcaktuar se: 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1. Shtesa për kushte specifike të punës përfitohet nga zyrtaret/ët publik dhe të punësuarat/it e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin. Si dhe Rregulloren (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik konkretisht nenin 6 paragrafi 1, 2 nën paragrafi 2.1 2.2 dhe nenin 3 i cili përcakton se: 1. Shtesa për kushte specifike të punës është shtesë mujore që përfitohet nga zyrtarët publik dhe të punësuarit e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë së shtuar në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin. 2. Kategoria e pozitave që janë të ekspozuara ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë në mënyrë të shtuar jetën, për të përfituar këtë shtesë mujore, duhet të plotësojnë kriteret si në vijim: 2.1. hetimi në teren, ku për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës; 2.2. kryerja e detyrave në operacione të rrezikshme, të cilët për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës. 3. Në secilën situatë, shtesa për kushte specifike të punës nuk mund të përfitohet nga nëpunësit në strukturat përgjegjëse për funksionet e brendshme administrative të institucioneve përkatëse. Si rrjedhojë e elaborimit si më lartë Kolegji ka konstatuar se bazuar në përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit i cili mbanë pozitën "Zyrtar Ligjor 1" - LI/070 në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër në Komunën e Suharekës i cili kërkon që ti njihet e drejta për shtesë të rrezikshmërisë në vendin e punës, Kolegji ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 3 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik pasi që i njëjti është nëpunës i zyrës, andaj pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.834/2023**

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Suharekës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Suharekës;
- Arkivoit të KPMSHCK-së

